



Koalicioni Të gjithë për gjykime të drejta

Projekti:

**Monitorimi i përgjigjes institucionale ndaj
parregullsive zgjedhore**

**Raport progresi
(Progress Report)**

Shkup, dhjetor 2008

Monitorimi i përgjigjes institucionale ndaj parregullsive zgjedhore

Autorë:

*prof. d-r. Tanja Karakamisheva
Aleksandar Çiçakovski*

Botues:

*Koalicioni Të gjithë për gjykime të drejta
rr. Makedonija nr. 11/2-10
1000 Shkup, R. E Maqedonisë
tel/faks: +389 2 3215-263
e-mail: contact@all4fairtrials.org.mk
www.all4fairtrials.org.mk*

Për botuesin:

Anica Tomshiq Stojkovska, Drejtor ekzekutiv

Redaktor:

Bekim Hoxha, Projekt Koordinator

Dizajni, kopertina dhe shtypi:

*Shtypshkronja FAMA - Shkup
tel: 3212-002
e-mail: famarben@hotmail.com*

Mbështetur nga:



Organization for Security and Co-operation in Europe
Spillover Monitor
Mission to Skopje



FOUNDATION ФОНДАЦИЈА
ОПЕНТИТУТ
СОЦИЈЕТВОРНО
ИНСТИТУТСТВО
МАКЕДОНИЈА МАКЕДОНИЈА

Përmbajtja e këtij botimi domosdo nuk i präfaqëson vështrimet ose pozitën e Misionit vëzhgues të OSBE në Shkup

Përmbajtja

Parafjalë.....	4
Pjesa e parë: analiza e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të vitit 2008 – dobësitë dhe problemet e konstatuara në pajtim me fazat nëpër të cilat kalon procesi zgjedhor në Republikën e Maqedonisë.....	9
1. Regjistrimi i zgjedhësve dhe freskimi i regjistrit zgjedhor – dobësitë dhe problemet e konstatuara.....	11
2. Procedura e kandidimit.....	11
Përgjigjja institucionale problemeve të konstatuara.....	12
3. Fushata zgjedhore dhe paraqitja mediale.....	12
Përgjigjja institucionale problemeve të konstatuara.....	14
4. Administrata zgjedhore dhe dita e votimit.....	15
Përgjigjja institucionale problemeve të konstatuara.....	16
5. Votimi dhe mbrojtja e të drejtës votuese.....	17
Përgjigjja institucionale problemeve të konstatuara.....	17
6. Dobësi dhe probleme në procedurën e numërimit të votave.....	18
Përgjigjja institucionale problemeve të konstatuara.....	18
7. Financimi i fushatës zgjedhore dhe raportet financiare.....	19
Përgjigjja institucionale problemeve të konstatuara.....	19
Pjesa e dytë: Mbrojtja juridiko-penale e procesit zgjedhor.....	20
1. Persona të kallëzuar.....	21
2. Struktura e veprave të kallëzuara.....	21
3. Vendi i kryerjes së veprave të kallëzuara.....	22
4. Organizueshmëria gjatë kryerjes së veprave të kallëzuara.....	23
5. Veprimi i prokurorive publike.....	23
6. Kohëzgjatja e procedurës.....	25
Pjesa e tretë: Përfundime.....	27
Shtesë – Tabela e rasteve penale.....	29

Raport për progresin e projektit për Monitorimin e përgjigjes institucionale ndaj parregullsisve zgjedhore lidhur me zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2008

Parafjalë

Raporti për progres të përgjigjes institucionale kundër parregullsisve zgjedhore është produkt i Projektit “Monitorimi i përgjigjeve institucionale ndaj parregullsisve zgjedhore” i cili implementohet nga ana e Koalicionit “Të gjithë për gjykime të drejta” në gjysmën e dytë të vitit 2008 dhe do të vazhdojë me implementim në gjysmën e parë të vitit 2009. Projekti financohet nga Misioni vëzhgues i OSBE në Shkup (gjatë vitit 2008) dhe nga Fondacioni Institut shoqëri e hapur – Maqedonia (gjatë vitit 2009). Objektivi kryesor i projektit është të kontribuojë drejt procesit demokratik zgjedhor dhe sundimit të së drejtës në Republikën e Maqedonisë.

Ky objektivi i përgjithshëm i projektit rrodhi nga gjendja e cila u formua pas shpalljes së zgjedhjeve të parakohshme parlamentare dhe parregullsisve të shumta të cilat objektivisht ndodhën gjatë procesit zgjedhor. Vlerësimi i përgjithshëm i monitoruesve të akredituar ndërkombëtar dhe vendor është se përpjekjet kyçe të OSBE dhe Këshillit të Evropës për zgjedhjet e parakohshme nuk u plotësuan dhe se numri i madh i parregullsisve vë në pah faktin se segmente të caktuara të procesit zgjedhor kanë qenë seriozisht të përkeqësuar për dallim nga ciklet paraprake zgjedhore. Monitoruesit vendor dhe ndërkombëtar të procesit zgjedhor gjatë fushatës parazgjedhore, veçanërisht në pjesët e banuara kryesisht me popullatë shqiptare, në vazhdimësi regjistruan raste të dhunës dhe frikësimit si ndaj votuesve dhe konkurrentëve politik, ashtu edhe ndaj administratës zgjedhore¹. Në ditën e zgjedhjeve, më 1 qershor, edhe në rizgjedhjet që vijuan, nga ana e monitoruesve u detektuan aktivitete të organizuara që në mënyrë të dhunshme të prishet procesi i votimit, gjë që rezultoi në pamundësi të votuesve në shumë vende lirisht ta shfaqin

¹ Asociacioni qytetar MOST, Raporti përfundimtar për zgjedhjet e parakohshme parlamentare 2008

vullnetin e vet². Në shumë qendra votuese votimi as që filloi për shkak të vjedhjes së materialit zgjedhor³, ndërsa në një numër të madh qendrash votuese u konstatua mbushje e kutive votuese, probleme me procesverbalet e votimit si dhe nënshkrime identike në regjistrat votues⁴.

Mu për shkak të kontekstit të këtyre të kësaj lloji të procesit zgjedhor, Projekti "Monitorimi i përgjigjeve institucionale ndaj parregullsive zgjedhore" përpiket të jep pasqyrë objektive dhe gjithëpërfshirëse për përgjigjet institucionale kundër parregullsive zgjedhore, me qëllim që të kontribuojë drejt vendosjes së sërishme të besimit të opinionit në procesin zgjedhor dhe në kapacitetet demokratike të vendit. Kjo është veçanërisht e rëndësishme duke pas parasysh atë që Republika e Maqedonisë ka pranuar obligime ndërkombëtare (veçanërisht me anëtarësimin në OKB, OSBE, Këshillin e Evropës dhe organizata tjera ndërkombëtare), për realizim të procesit zgjedhor të drejtë dhe demokratik. Zgjedhjet e drejta dhe demokratike janë patjetërsi edhe në procesin (kriter) për integrim të suksesshëm dhe të përshpejtuar të vendit në Unionin evropian. Procesi zgjedhor ishte lëndë e observimit të hollësishëm edhe në raportin e fundit të Komisionit evropian për progresin e Republikës së Maqedonisë. Projekti në vete i bashkon sektorin joqeveritar, opinionin kompetent dhe bashkësinë ndërkombëtare dhe si i tillë duhet të paraqesë udhërrëfyes të llojit të veçantë për institucionet shtetërore për ballafaqim më të mirë në të ardhmen me parregullsitë zgjedhore.

Ky raport për progres jep prerje të gjendjes momentale në veprimin e institucioneve shtetërore në pajtim me të dhënat të cilat Koalicioni arriti ti grumbullojë disa muajt e kaluar gjatë implementimit të aktiviteteve të projektit. Mirëpo, vazhdimisht duhet pas parasysh se më tepër veprime dhe reagime institucionale kundër parregullsive zgjedhore, veçanërisht në prokurori dhe gjyqësor, ende janë ende në vazhdim e sipër. Poashtu, duhet pas parasysh se gjatë grumbullimit të të dhënave, edhe përkaj përpyekjeve të Koalicionit, institucione të ndryshme informuan për procedurat të cilat zhvillohen në ato sipas kriterëve dhe metodologjisë së

² Përfundime preliminare, OSBE/ODIHR, 2 qershor 2008, Në njërin prej incidenteve i cili ndodhi në Haraçinë një person përfitoi plagë fatale, dhe një person përfitoi plagë të rënda prej armëve të zjarrit në incident i cili ndodhi në Çair. Në Gostivar dy vendotime u mbyllën pas vjedhjes së materialit zgjedhor nga ana e personave të armatosur dhe të gjithë anëtarët e KZ janë përzënë nga vendotimi. Votimi poashtu është ndërprerë gjatë mëngjesit edhe në komunën Çučer Sandevë ku përafërsisht 30 persona të panjohur kanë hyrë në vendotim, i kanë frikësuar anëtarët e KZ dhe e kanë vjedhur materialin zgjedhor. Gjatë votimit nga ana e vëzhguesve vendor dhe ndërkombëtar janë vërejtur shumë parregullsi.

³ OSBE/ODIHR, Raporti final për zgjedhjet e parakohshme parlamentare 2008, f. 18, në fshatin Banjicë e Epërm dhe në komunën Saraj në dy vendotime.

⁴ OSBE/ODIHR, Raporti final për zgjedhjet e parakohshme parlamentare 2008, f. 18

ndryshme. Njëlloj, pjesa më e madhe e çështjeve të cilat janë të përfshira në këtë Raport për progres vetëm janë përmendur si probleme dhe do të përpunohen më hollësisht në Raportin përfundimtar i cili do të finalizohet nga mesi i vitit 2009.

Koalicioni "Të gjithë për gjykime të drejta" këtë proces vëzhgues e realizoi sipas metodologjisë së vet standarde. Përmes kontakteve dhe qasjeve të drejtpërdrejta me institucionet shtetërore, si dhe përmes rrjetit të vet të vëzhguesve të lëndëve gjyqësore, Koalicioni grumbullon material empirik i cili është lëndë e analizës kompetente nga ana e dy konsultantëve: prof. d-r Tanja Karakamisheva⁵ (autor i pjesës së parë) dhe Aleksandar Çiçakovski⁶ (autor i pjesës së dytë). Raporti përbëhet prej tre pjesëve: pjesa e parë ka të bëjë me problemet lidhur me vet procesin zgjedhor dhe çështje të cilat në mënyrë direkte janë në lidhje me atë, ndërsa pjesa e dytë është në lidhje me mbrojtjen juridiko-penale të procesit zgjedhor. Pjesa e tretë shkurtimisht i përmbledh përfundimet fillestare deri tek cilët arrihet në bazë të të dhënave të analizuar. Për dallim nga projektet e veta të deritanishme për monitorim, këtë radhë Koalicioni e zgjeroi përqendrimin e vet edhe në institucione tjera shtetërore, e jo vetëm në gjyqësorin. Prandaj, Raporti paraqet kontribut të veçantë në këtë sferë në Republikën e Maqedonisë dhe do të duhej të jetë i dobishëm për më tepër institucione: gjyqësinë, organet e pushtetit ekzekutiv si dhe organet dhe trupat e pavarura të përfshira në proceset zgjedhore.

Në fund, në këtë pjesë hyrëse duhet ti shkurtimisht kushtohet vëmendje edhe standardeve ndërkombëtare dhe evropiane për realizimin e zgjedhjeve të drejta dhe demokratike si pikë referente gjegjësisht prizmë nëpër të cilën vështrohet dhe vlerësohet procesi zgjedhor në Republikën e Maqedonisë.

Së këtejmi, në të drejtën zgjedhore bëhet dallim mes standardeve evropiane dhe ndërkombëtare. Standardet evropiane përfshihen në dokumentet evropiane, ndërsa ato ndërkombëtare, më së shpeshti, në marrëveshjet dhe dokumentet e OKB.

⁵ Profesor inordiner në sferën shkencore E drejta kushtetuese dhe sistemi politik në Fakultetin Juridik "Justiniani i parë" dhe zëvendës anëtar i Komisionit të Venedikut pranë Këshillit të Evropës nga Republika e Maqedonisë.

⁶ Analist juridik në asociacionin qytetar MOST dhe magjistrant në sferën e të drejtës penale dhe kriminologjisë pranë Fakultetit Juridik "Justiniani i parë.

Standardet janë të përmbledhura në dy instrumente juridike: instrumente të cilat nuk kanë dhe të cilat kanë obligueshmëri juridike. Grupi i parë i instrumenteve juridik në të cilat përfshihen standardet evropiane që nuk kanë efekt obligativ juridik për shtetet i takojnë të ashtuquajturës të drejtë të “butë” (soft law)⁷.

Edhe pse këto standarde janë juridikisht të paobligueshme, prapseprap autoriteti i këtyre organizatave të cilat i caktojnë, ju jep peshë morale dhe kompetente për të cilën Evropa veçanërisht insiston, me atë që ato janë politikisht të obligueshme (si për shembull standardet e OSBE)⁸.

Instrumentet juridike evropiane të cilat hyjnë në grupin “hard core” përmbajnë standarde obliguese zgjedhore⁹.

Standardet ndërkombëtare zgjedhore të cilat kanë efekt obligues juridik përfshihen në:

- nenin 21 të Deklaratës universale për të drejtat e njeriut,
- nenin 25 (b) të Konventës ndërkombëtare për të drejta qytetare dhe politike,
- nenin 1 të Konventës për të drejtat politike të gruas,
- nenin 5 të Konventës Ndërkombëtare për eliminimin e të gjithë formave të diskriminimit racor, dhe
- nenit 7 të Konventës për eliminimin e të gjithë formave të diskriminimit të grave, etj.

⁷ Mendime interesante për të drejtën e „butë” si produkt i ndryshimeve globaliste të cilat e ndryshuan rolin e shtetit dhe e drejtuan kahjen e lëvizjes së rendit shoqëror drejt promovimit dhe mbrojtjes së standardeve rregullator të cilat ndërtohen sipas atyre universaleve, e jo sipas interesave nacional. Shih në veprën e: **D. Shelton, Commitment and Compliance: What Role for International Soft Law?**, <http://www.ceip.org/programs/global/semshelton.htm>.

⁸ Si standarde zgjedhore me karakter të paobligueshëm radhiten përmbajtjet e përfshira në:

- a) Rekomandimet zgjedhore të vitit 2002 të komisionit të Venedikut të pranuar në formë të **Kodikut të praktikës së mirë për çështjet zgjedhore** nga ana e Asamblesë parlamentare të Këshillit të Evropës më 28 janar 2003, ndërsa të pranuar edhe nga Komiteti i ministrave pranë Këshillit të Evropës;
- b) **Rekomandimet për zgjedhje demokratike të OSBE dhe vendeve pjesëmarrëse nga viti 2003**
- c) **Deklarata për kriterin zgjedhje të drejta dhe të lira** të pranuar nga Këshilli interparlamentar në sesionin e tij të 154 në Paris 1994.

⁹ Ato janë: **Protokolli i parë (neni 3) i Konventës evropiane për të drejtat e njeriut**, neni 6 i **Konventës për pjesëmarrje të të huajve në jetën publike në nivel lokal**, jurisprudenca e **Gjyqit evropian për të drejtat e njeriut** lidhur me aplikimin e nenit 3 të protokollit të parë të KEDNJ, **ligji themelor – neni 8 b (1) i Marrëveshjes së UE, direktivave të Këshillit 93/109 dhe 94/80 të BE**, etj.

Britja e numrit të standardeve ndërkombëtare dhe evropiane padyshim se është tregues i përparimit të bashkëpunimit, demokratizimit dhe sundimit të së drejtës në bashkësinë ndërkombëtare. Bëhet fjalë për instrumente të cilat në procesin e harmonizimit, unifikimit dhe zbatimit të vlerave, parimeve, praktikave dhe teknikave më të mira të zgjedhjeve demokratike i legjitimojnë pushtetet demokratike nëpër shtete.

Standardet evropiane dhe ndërkombëtare duhet të respektohen në kushte të mungesës së dokumenteve obligues ndërkombëtar dhe evropian kushtuar çështjeve zgjedhore të cilat më hollësisht do ta kishin përpunuar këtë problematikë. Duke gjurmuar për një sistem në të cilin do të paraqiten standarde supranacionale në sferën e zgjedhjeve, organizatat ndërkombëtare, Këshilli i Evropës dhe Komisioni evropian janë përqendruar në promovimin e të ashtuquajturve makro-kushte si vlera dhe parime të cilat do të paraqiten si mbrojtës i përmbajtjes demokratike të zgjedhjeve të drejta dhe të lira. Organizimi i zgjedhjeve dhe sistemet zgjedhor janë çështje tradicionalisht të lëna në ingerenca të shteteve nacionale.

Pjesa e parë: Analiza e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të vitit 2008 – dobësitë dhe problemet e konstatuara sipas fazave nëpër të cilat kalon procesi zgjedhor në Republikën e Maqedonisë

Vrojtime të përgjithshme për strukturën e kornizës juridike kushtuar zgjedhjeve në Republikën e Maqedonisë

Secili shtet në mënyrë vetjake i cakton rregullat të cilat e përbëjnë kornizën për materien zgjedhore, gjatë kësaj shteti ka të drejtë që vet të vendosë se çfarë sistemi zgjedhor dhe me çfarë rregulla do të realizohet procesi zgjedhor. Gjatë zgjedhjes së rregullave është normale që shteti duhet të çojë llogari edhe për obligimet të cilat i ka ndërmarrë si nënshkrues i dokumenteve ndërkombëtar, respektivisht evropian të cilat në mënyrë direkte ose indirekte i rregullojnë çështjet zgjedhore.

Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, mes cilave është edhe Republika e Maqedonisë, gjatë anëtarësimit në organizatë nënshkruajnë se obligohen ti realizojnë zgjedhjet (presidenciale, parlamentare dhe lokale) përmes respektimit dhe plotësimit të standardeve evropiane.

Ky obligim është pjesë edhe nga Konventa evropiane për të drejtat e njeriut.

Në këtë kuptim, aplikimi i standardeve të përmbajtura në Kodikun për praktika të mira për çështjet zgjedhore të Komisionit të Venedikut në Republikën e Maqedonisë, konsiderohet si hap i domosdoshëm në drejtim të zbatimit dhe respektimit të obligimeve të pranuar. Nëse ndonjë shtet vendos të mos i respektojë rekomandimet e komisionit të Venedikut, ndërsa si rezultat i asaj ndonjë qytetar parashtron ankesë para Gjyqit evropian për të drejtat e njeriut për shkak të mosrespektimit të Konventës evropiane për të drejtat e njeriut, shteti do të duhet ta sqarojë mirë arsyen pse nuk i ka respektuar rekomandimet dhe Kodikun e Komisionit të Venedikut para gjyqit edhe pse është dashur ta bëjë atë.

Përndryshe, korniza juridike sipas së cilës zbatohen zgjedhjet në Republikën e Maqedonisë është Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë,

Kodi zgjedhor i Republikës së Maqedonisë i cili hyri në fuqi më 31 mars të vitit 2006 si dhe ndryshimet dhe plotësimet më të reja të Kodit zgjedhor.

Sistemi juridik i RM parasheh disa kanale për mbrojtje të të drejtave zgjedhore dhe sigurim të procesit zgjedhor të drejtë dhe demokratik. Kanali i parë është proceduar për mbrojtje të të drejtave zgjedhore e cila udhëhiqet para organeve zgjedhore të cilët janë kompetent për sigurimin e ligjshmërisë në realizimin e procesit zgjedhor. Në lidhje me vendimet e organeve zgjedhore është paraparë me mbrojtje gjyqësore të të drejtave zgjedhore që sigurohet përmes Gjyqit suprem (me ndryshimet dhe plotësimet e Kodit zgjedhor, prej tetorit 2008 para Gjykatës supreme). Kanali i dytë procesor për përgjigje institucionale është procedura penale e cila udhëhiqet para gjykatave për kundërvajtje. Në këtë kontekst veçanërisht me rëndësi është përgjigja juridiko – kundërvajtëse ndaj parregullive zgjedhore, i cili poashtu është formë e mbrojtjes gjyqësore të të drejtave zgjedhore (përgjigjja juridiko – penale është lëndë e shqyrtimit në pjesën e dytë).

Vëllimi i efikasitetit dhe përgjigjja institucionale ndaj parregullive zgjedhore determinohet si nga instrumentariumi juridik, por ende më tepër nga kapacitetet institucionale dhe nga vullneti për aplikimin konsistent nga ana e organeve kompetent. Çështja ndërlikohet me faktin se struktura politike e cila ka fituar legjitimitet përmes zgjedhjeve duhet ti zbulojnë dhe ndjekin kryesit e parregullive zgjedhore¹⁰. Mirëpo, në shoqëritë demokratike ku respektohet sundimi i të drejtës, nuk ka alternativë tjetër për shkak se qytetarët presin që rregullat e lojës paraprakisht të pranuar të respektohen dhe kryesit e parregullive zgjedhore të dënohen, për shkak se në të kundërtën vjen deri në humbje të besimit të qytetarëve në procesin zgjedhor ose deri në dyshim në drejtësinë e rezultateve zgjedhore, që më tej e sjell në pyetje legjitimitetin e vet përfaqësuesve të zgjedhur.

¹⁰ Kambovski, E drejta ndëshkuese – pjesa e veçantë, botimi i tretë, Shkup 1997, f. 139

1. Regjistrimi i votuesve dhe freskimi i regjistrit zgjedhor – dobësitë dhe problemet e konstatuara

Në Raportin final të Asociacionit qytetar MOST konstatohen probleme me regjistrin zgjedhor¹¹. Konstatimi i njëjtë përmbahet edhe në versionin përfundimtar të raportit të OSBE/ODIHR në të cilin theksohet se në 8% të vendvotimeve të vizituara prej Misionit për vëzhgim të zgjedhjeve të OSBE/ODIHR ka pasur persona të cilëve nuk ju është lejuar të votojnë për shkak se nuk kanë qenë në regjistrin votues¹².

2. Procedura e kandidimit

Dobësi dhe probleme në procedurën e kandidimit

Në zgjedhjet e parakohshme parlamentare në vitin 2008, në procedurën e kandidimit dhe procedurën e vërtetimit të listave të kandidatëve, u vërejtën disa probleme:

- a) gjashtë lista të Forcave të bashkuara maqedonase – Partia gjithëmaqedonase punëtore nuk kishin deklarata për pranimin e kandidaturave të vërtetuara në notar,
- b) lista e vërtetuar e kandidatëve për zgjedhje të deputetëve në Njësinë zgjedhore nr. 6 të dorëzuara nga VMRO – popullore nuk kishte gjiro llogari të hapur me vërejtjen “për fushatën zgjedhore” në afat prej 48 orëve pas vërtetimit të listës,
- c) ngjashmëria me emrat dhe mbiemrat e kandidatëve në listat e kandidatëve të Partisë social – demokratike të Maqedonisë me emrat dhe mbiemrat e bartësve të listës së kandidatëve të Koalicionit “Sonce” dhe
- d) në listat e kandidatëve për njësinë zgjedhore nr. 2 të koalicionit të udhëhequr nga VMRO – DPMNE u gjet kandidat të cilit me verdikt fuqjplotë gjyqësor i është shqiptuar dënim me burg prej së paku gjashtë muajve.

¹¹ Shiko: Zgjedhjet e parakohshme parlamentare 2008, **Raporti final i Asociacionit qytetar MOST**, Shkup, vit 2008, (f. 17).

¹² Shiko: Zgjedhjet e parakohshme parlamentare 1 qershor 2008, Misioni për vëzhgim të zgjedhjeve i OSBE/ODIHR, Raporti përfundimtar, Varshavë, 20 gusht 2008, (f. 10).

Përgjigje institucionale problemeve të konstatuara

Në lidhje me situatën e parë, Komisioni shtetëror zgjedhor me vendim i refuzoi të gjashtë listat e partisë Forcat e bashkuara maqedonase - Partia githëmaqedonase punëtore për shkak të dokumentacionit të pa kompletuar.

Në lidhje me situatën e dytë, Komisioni shtetëror zgjedhor me vendim e anuloi listën veçse të vërtetuar për shkak se VMRO – Popullore nuk e ka respektuar afatin ligjor prej 48 orëve pas vërtetimit të listës së kandidatëve që të hap gjiro llogari me vërejtjen “për fushatën zgjedhore” sipas nenit 71, paragrafi 1 dhe 2 nga Kodi zgjedhor.

Në lidhje me situatën e tretë, Komisioni shtetëror zgjedhor përfundoi se listat e kandidatëve të Partisë social-demokratike të Maqedonisë i plotësojnë të gjithë kushtet ligjore për shkak se nuk ekzistojnë baza ligjore për anulimin e listave.

Në lidhje me situatën e katërt, KShZ solli vendim për vërtetimin e listës së kandidatëve me shpjegim se Gjykata kushtetuese e RM ka ndërmarrë qëndrim se kjo nuk mund të jetë kusht për funksion zgjedhor.

3. Fushata zgjedhore dhe paraqitja mediale

Dobësitë dhe problemet në organizimin dhe udhëheqjen e fushatës zgjedhore si dhe gjatë procedurës së paraqitjes mediale të kandidatëve zgjedhor

1. U vërejt mosrespektim i nenit 186 të Kodit zgjedhor, shkatërrim i afisheve zgjedhore (flamuj të partisë politike) gjatë kohës së mbajtjes së mitingjeve parazgjedhor të partive politike si dhe disa prishje të rendit publik dhe qetësisë.

2. Problemi i parë më serioz i cili u paraqit rreth fushatës zgjedhore të këtyre të fundit, por i njëjti zvarritet edhe nëpër të gjithë zgjedhjet paraprake parlamentare dhe të tjera, është fillimi i parakohshëm i paraqitjes mediale të kandidatëve të listave partiake para qytetarëve. Me këtë u ra ndesh me nenin 74 të Kodit zgjedhor ku thuhet se fushata zgjedhore fillon 20 ditë para ditës së caktuar për mbajtjen e zgjedhjeve

dhe nuk guxon të zgjasë 24 orë para ditës së zgjedhjeve dhe në ditën e votimit.

3. Mosrespektim i obligimit ligjor për qasje të barabartë në prezantimin e programeve zgjedhor të kandidatëve. Njëkohësisht, duhet përmendur se Kuvendi i Republikës së Maqedonisë para se të vetëshpërndahet nuk sollti vendim për rregullat e qasjes së barabartë për prezantim të barabartë me propozim të Këshillit për radiodifuzion me çka u ra ndesh me nenin 75, paragrafi 3 i Kodit zgjedhor të RM. Këshilli për radiodifuzion sollti udhëzim për prezantim medial.

4. Mosrespektim i obligimit për kohëzgjatjen e prezantimit zgjedhor në kuptim të mbulimit të balancuar dhe të paanshëm të zgjedhjeve në programin e përgjithshëm të medimeve si dhe thyerje e parimit të proporcionalitetit sipas numrit të listave të vërtetuara të kandidatëve.

5. Shkelja e heshtjes zgjedhore veçanërisht më 31 maj dhe 1 qershor, por edhe gjatë rivotimeve në disa vendvotime më 14 dhe 15 qershor nga ana e më tepër medimeve¹³.

6. Komunitat dhe qyteti i Shkupit nuk e kanë respektuar obligimin ligjor për shënimin e vendeve në të cilat lejohet ngjitja e afisheve pa kompensim për secilin parashtrues të listave ndaras.

7. Në disa raste ekziston thyerje evidente e nenit 84 të Kodit zgjedhor i cili ka të bëjë me mjetet e shpenzuara gjatë fushatës elektorale jashtë limitit të lejuar të caktuar për secilin organizator të fushatës. Vërehet jotërësi e raporteve financiare të partive, pasaktësi dhe paqartësi në artikujt të përmbajtur në raportet dhe jorealitet për shumën e paraqitur si të shpenzuar në lidhje me shpenzimet e vërteta të realizuara në fushatë. Në raportin final të projektit do të prezantohen problemet lidhur me raportet financiare, financimin e partive dhe kontrollin e institucioneve kompetente shtetërore.

¹³ Më hollësisht në informata të Këshillit për radiodifuzion të Republikës së Maqedonisë të paraqitur në pres konferencë më 26 qershor 2008. Më 31 maj heshtjen zgjedhore e kanë thyer TVM1, TVM2-Programi në gjuhën shqipe, Radio e Maqedonisë-Programi i parë, TV Sitel, TV Shutel, nga Shkupi, TV Zdravkin nga Velesi, TV Kiss nga Tetova, TV Gurra nga Kërçova dhe TV Nova nga Gjevgjelia. Më 1 qershor, në ditën e votimit, heshtjen e kanë thyer TV Sitel, TV A1, TV Alsat M, Radio Kanal 77, TV Skajnet, TV BTR dhe TV MTM nga Shkupi, TV Nova nga Kumanova dhe TV Kiss nga Tetova, derisa më 14 qershor heshtjen zgjedhore e kanë thyer TVM1, TV Alsat M, Radio e Maqedonisë-Programi i parë dhe TV Kiss nga Tetova, ndërsa më 15 qershor, në ditën e votimit të përsëritur në disa vendvotime, heshtjen nuk e kanë respektuar MTV1 dhe TV Kanal 5. Për këto thyerje Këshilli e informoi Agjencinë për komunikime elektronike e cila në pajtim me Kodin zgjedhor ngriti disa procedura për kundërvajtje kundër këtyre subjekteve.

Përgjigje institucionale problemeve të konstatuara

1. Nga ana e MPB është ngritur vetëm një kërkesë për kundërvajtje në Gjykatën themelore Tetovë, për thyerje të nenit 186 të kodit zgjedhor, për shkak të shkatërrimit të afisheve votuese (flamuj të partisë politike), në vend të caktuar për shpallje të tyre para mitingut të paraqitur si duhet. Janë ngritur edhe tetë kërkesa kundërvajtëse në gjykatat themelore: Tetovë, Gostivar, Kumanovë, Strugë dhe Shtip, për prishje të qetësisë dhe rendit publik, nga Ligji për kundërvajtje kundër rendit dhe qetësisë, nga Ligji për armë dhe Ligji për siguri të komunikacionit nëpër rrugë. Janë paditur 18 persona të cilët kanë qenë kryes ose pjesëmarrës në kryerjen e këtyre kundërvajtjeve. Këto kundërvajtje janë bërë gjatë fushatës zgjedhore dhe në ditën e votimit kryesisht në territorin e Tetovës dhe të Gostivarit (gjashtë raste), ndërsa vetëm nga një rast ka pas në Shtip, Strugë dhe Kumanovë.

2. Rreth fillimit të parakohshëm të fushatës zgjedhore nëpërmjet prezantimit të parakohshëm medial të kandidatëve të listave partiake para qytetarëve, nuk ka të dhëna për përgjigje institucionale, gjegjësisht reagim institucional në drejtim të dënimit të personave (mediumeve) të cilët e kanë filluar fushatën para kohe. Komisioni shtetëror zgjedhor doli me qëndrim se nuk bëhet fjalë për fillim të parakohshëm të fushatës, por për aktivitete politik të kandidatëve.

3. Këshilli për radiodifuzion i Republikës së Maqedonisë shqiptoi 45 masa në pajtim me Ligjin për veprimtari radiodifuzive dhe 132 vërejtje në pajtim me udhëzuesin për prezantim media dhe si thyerje më të shpeshta u përcaktuan: a) tejkalimi i mjeteve të lejuara me reklamim politik, b) keqpërdorim i programeve të cilat nuk janë të lidhura me zgjedhjet në funksion të fushatës zgjedhore, c) ndarja e më tepër kohe nga e lejuara për reklamim politik, d) shpallja joadekuate e të dhënave nga hulumtimet e opinionit publik, etj.

Agjencia për komunikime elektronike ka ngritur 28 fletëparaqitje për shkak të prishjes së heshtjes zgjedhore në pajtim me dispozitat e Kodit zgjedhor, prej të cilave 12 kanë mbaruar me vendim gjyqësor në shkallën e parë.

Në 8 vendime gjyqësore janë shqiptuar gjoba për personin juridik në lartësi prej 200.000 denarëve, në dy gjobë për personin juridik në lartësi prej 210.000 denarë, një gjobë për person juridik në lartësi prej 100.000 denarë, dhe një gjobë për person përgjegjës në medium në lartësi prej

300.000 denarëve, si dhe 8 vendime të gjyqit për personin përgjegjës në medium në lartësi prej 10.000-30.000 denarë¹⁴.

Janë parashtruar edhe 4 ankesa kundër vendimeve të shkallës së parë deri në gjykatën e Apelit në Shkup, prej të cilave njëra është refuzuar me vendim për shkak të vonesës.

4. Administrata zgjedhore dhe dita e votimit

Dobësitë dhe problemet në administratën zgjedhore (KShZ, KZK, KZ) dhe dobësitë dhe problemet në ditën e votimit

1. Sipas raportit final të Asociacionit qytetar MOST, vëzhguesit e saj kanë lajmëruar se në 45 raste këshillat zgjedhor nuk i kanë pas të gjithë materialet e nevojshme zgjedhore si dhe në 303 raste – hapje e vonuar e vendotimeve që faktikisht janë lëshime në punën e këshillave zgjedhor.

2. Si lëshime në punën e këshillave zgjedhor numërohen edhe mbushja e vërejtur e kutive votuese, ndezja dhe marrja e materialit zgjedhor, votimi në emër të tjetërkujt, votimi familjar dhe grupor, mosrespektimi i procedurës për identifikim të votuesve, etj.

3. te zgjedhjet e realizuara për votuesit të cilët janë në shërbimin ushtarak, vuajtje të dënimit me burg ose paraburgim dhe për personat e zhvendosur, vëzhguesit e Misionit ndërkombëtar për vëzhgim kanë vërejtur 5 raste në të cilat këshillat zgjedhor nuk kanë siguruar kushte adekuate për fshehtësi të votimit, gjegjësisht në 24% të vëzhgimeve nuk janë respektuar rregullat për procesin e votimit¹⁵.

4. Komisioni shtetëror zgjedhor, në numër të madh rastesh, nuk ngriti fletëparaqitje për kundërvajtje në raste të cilat u përmendën paraprakisht (fillim i parakohshëm i fushatës zgjedhore, mosshpallje e vendeve nga ana e komunave për vendosje pa pagesë të afisheve dhe lloji tjetër të materialeve zgjedhor, etj).

¹⁴ Informata janë marrë nga pyetësorët e monitorimit të plotësuar nga ana e monitoruesve të Koalicionit "Të gjithë për gjykime të drejta", të përgatitura për nevojat e këtij projekti.

¹⁵ Shiko: Zgjedhjet e parakohshme parlamentare, 1 qershor 2008, Misioni për vëzhgim të zgjedhjeve i OSBE/ODIHR, Raporti përfundimtar, Varshavë, 20 gusht 2008 (f. 23)

5. KShZ nuk arriti të sigurojë mbrojtje maksimale të pjesëmarrësve në procesin zgjedhor kur të drejtat e tyre ishin të rrezikuara gjatë fushatës zgjedhore.

Përgjigje institucionale problemeve të konstatuara

1. KShZ shkarkoi gjashtë kryetarë të Komisioneve zgjedhor komunal në Saraj, Likovë, Tetovë, Brvenicë, Bogovinë dhe Gostivar për shkak të parregullsive serioze zgjedhore.

2. Te këshillat zgjedhor ku u konstatuan prishje të procesit zgjedhor të llojit të mbushjeve të kutive votuese, KShZ nuk bëri ndryshim të anëtarëve të tyre.

3. MPB informoi se nga gjithsej 25 raste të procedurës së ngritur për veprim të brendshëm disiplinor 18 janë kryer, prej 13 rasteve të 13 policëve ju është shqiptuar masa disiplinore zvogëlim i rrogës prej 15% për 6 muajt e ardhshëm, derisa për 5 të mbeturit procedura është kryer dhe priten masat. Për 7 raste tjera procedura ende vazhdon, ndërsa 13 policë janë suspenduar nga vendi i tyre i punës dhe kundër tyre është ngritur procedurë për kundërvajtje¹⁶.

5. Votimi dhe mbrojtja e të drejtës votuese

Dobësi dhe probleme në procedurën për votim dhe mbrojtje të së drejtës votuese

1. Për zgjedhjet e mbajtura më 1 qershor, deri në KShZ u parashtruan ankesa prej: PDSH (gjithsej 15), BDI (gjithsej 13), Sonce – Koalicioni për Evropë (gjithsej 1), TMRO (gjithsej 1), edhe Koalicioni VMRO-DPMNE (gjithsej 28). Ankesat u parashtruan për shkak të thyerjes së Kodit zgjedhor në procedurën e votimit në 376 vendvotime.

2. Për zgjedhjet e përsëritura të 29 qershorit deri te KShZ u parashtruan ankesa prej: PDSH (gjithsej 16) dhe BDI (gjithsej 8)¹⁷.

¹⁶ Shiko: **Information on Disciplinary Cases in MOI Related to Election Irregularities (10 August) si dhe Raporti përfundimtar i OSBE/ODIHR, 2008, (f. 29).**

¹⁷ Shiko: <http://www.sec.mk:90/index.php/prigovoriresenija/-01062008>,

3. Për zgjedhjet e përsëritura të 29 qershorit deri te KShZ u parashtruan ankesa prej: Partisë për prosperitet demokratik (gjithsej 4)¹⁸.

Përgjigje institucionale problemeve të konstatuara

1. KShZ veprroi sipas të gjitha ankesave në afatin e paraparë ligjor dhe sollti vendime¹⁹.

2. KShZ i anuloi rezultatet në 197 vendvotime prej të cilave 38 ishin anuluar sipas detyrimit zyrtar, ndërsa rezultatet në vendvotimet tjera u anuluan për shkak të procesverbaleve të pasaktë ose të panënshkruar nga anëtarët e KZ, për shkak të votimit në emër të tjetërkujt, për shkak të mospajtimit të numrit të votuesve me numrin e fletëvotimeve në kutitë zgjedhore, etj.

Indikative është e dhëna që në procedurën sipas ankesave në lidhje me votimin në rrethin e parë zgjedhor, KShZ gjatë kontrollit të materialit zgjedhor nga 100 vendvotime, në 94 ka vërtetuar parregullsi të kryera më së shpeshti me votim të një personi më tepër herë²⁰. Fakt për parregullsitë e këtilla ishin ekstraktet prej regjistrave votuese në të cilat me një nënshkrim të njëjtë janë nënshkruar më tepër votues të cilët fjala se e kanë shfrytëzuar të drejtën e vet të votimit . në të gjithë këto raste, edhe përkaj ekzistimit të bazave për dyshim për vepra të kryera penale, organet zgjedhore nuk i paraqitën veprat.

3. Pas vendimeve të KShZ tre parti politike parashtruan ankesa deri te Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë²¹.

6. Dobësi dhe probleme në procedurën për numërimin e votave

1. Në 111 vendvotime numërimi i votave u vlerësua si i dobët nga ana e vëzhguesve të OSBE, gjegjësisht si shumë i dobët në 15% të vendvotimeve të vizituara.

<http://www.sec.mk:90/index.php/prigovoriresenija/-15062008>,

<http://www.sec.mk:90/index.php/prigovoriresenija/dik2906>.

¹⁸ Bazën juridike të ankesave më hollësisht do ta trajtoj në raportin final të projektit.

¹⁹ Vendimet e KShZ dhe ankesat gjegjësisht vendimet e Gjykatës supreme, më hollësisht do të përpunohen në raportin final të projektit.

²⁰ OSCE/ODIHR Election observation mission, Early parliamentary elections 2008, Final report, page 21

²¹ Shiko: Zgjedhjet e parakohshme parlamentare, 1 qershor 2008, Misioni për vëzhgim të zgjedhjeve i OSBE/ODIHR, Raporti përfundimtar, Varshavë, 20 gusht 2008 (f. 26)

2. Edhe në KZK ku gjendeshin këto 111 vendvotime u vërejt përmbledhje e dobët, gjegjësisht shumë e dobët e rezultateve zgjedhore.

Përgjigje institucionale problemeve të konstatuara

1. Në pjesën më të madhe të vendvotimeve ku u vërejtën parregullsi të këtitilla, KShZ e anuloi votimin me vendim.

7. Financim i fushatës zgjedhore dhe raporte financiare

Dobësi dhe probleme në veprimin sipas raporteve financiare të partive politike për financimin e fushatës zgjedhore

1. Në të gjithë raportet e dorëzuara financiare për shpenzimin e mjeteve për fushatë zgjedhore vërehet pasaktësi dhe paqartësi në paragrafët e përmbajtur në raportet dhe jorealitet i shumave të prezantuara në lidhje me shpenzimet e vërteta të realizuara në fushatë. Në Raportin finaë të projektit më hollësisht do të parashtrohen problemet në lidhje me raportet financiare, financimi i partive dhe kontrolli i organeve kompetente shtetërore duke i pas parasysh të dhënat e raportit të Entit shtetëror për revizion në lidhje me zgjedhjet.

Përgjigje institucionale problemeve të konstatuara

Në lidhje me financimin e fushatave, OSBE/ODIHR në raportin e vet ka vërejtur se nuk ekzistojnë mekanizma efikas për kontroll²² dhe se mbetet përshtypja se organizatorë të caktuar të fushatës i kanë tejkaluar limitet ligjore. Përfundimet e këtitilla vërtetohen edhe me Përfundimet e mbledhjes së komisionit shtetëror për pengimin e korrupsionit të mbajtur më 5-6.08.2008. edhe përskaj kësaj, KShZ deri më tani nuk ka ngritur procedurë kundërvajtëse për thyerjen e dispozitave për financimin e fushatës zgjedhore në pajtim me nenin 180 të Kodit zgjedhor, e as ka iniciuar procedurë për përgjegjësi penale sipas nenit 165-a të Kodit penal.

²² OSBE/ODIHR Raporti final për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2008, f. 11

Pjesa e dytë: Mbrojtja juridiko-penale e procesit zgjedhor

Vrojtime të përgjithshme

Kodi penal i Republikës së Maqedonisë parashikon nëntë vepra penale kundër sistemit zgjedhor: Pengim i zgjedhjeve dhe votimit (neni 158), Thyerje e t; drejt; s votuese (neni 159), Thyerje e të drejtës për përcaktim të votuesve (neni 160), Keqpërdorim i të drejtës votuese (neni 161), Ryshfet gjatë zgjedhjeve dhe votimit (neni 162), Thyerja e fshehtësisë së votimit (neni 163), Shkatërrimi i dokumenteve zgjedhor (neni 164), Mashtrim zgjedhor (neni 164), keqpërdorim i mjeteve për financim të fushatës zgjedhore (neni 165-a) ²³. Ato janë të sistemuara në kapitull të veçantë (kapitulli gjashtëmbëdhjetë) i cili mban titullin “Vepra penale kundër zgjedhjeve dhe votimit”. Objekt i përbashkët grupor i mbrojtjes së veprave penale kundër zgjedhjeve është sistemi zgjedhor i cili paraqet shumë të parimeve dhe procedurave që duhet të sigurojë zgjedhje të lira,, të drejtpërdrejta dhe demokratike që është vlerë themelore e rendit kushtetues të Republikës së Maqedonisë. Objekt tjetër grupor i mbrojtjes është e drejta aktive dhe pasive zgjedhore, gjegjësisht e drejta për votim të barabartë, të përgjithshëm dhe të drejtpërdrejtë e votimit, e drejta e secilit qytetar të merr pjesë në ushtrimin e funksionit publik si dhe parimi i realizimit të këtyre të drejtave vetëm përmes zgjedhjeve të lira me votim të fshehtë.

Esencat ligjore të të gjithë veprave penale me ndryshimet dhe plotësimet e Kodit zgjedhor²⁴, pësuan ndryshime në pjesën e dënimeve të parapara, në drejtim të ashpërsimit të tyre drastik, ndërsa disa prej veprave penale pësuan ndryshime edhe në vet përshkrimet e esencave ligjore të veprave penale, derisa me nenin 165-a u vendos inkriminim i ri: Keqpërdorim i mjeteve për financimin e fushatës zgjedhore. Nga esencat ligjore të veprave penale vërehet se të njëjtat ofrojnë mbrojtje solide ndëshkuese juridike. Mirëpo, praktika tregon se te veprime të caktuara inkriminuese ekzistojnë josaktësi të caktuara dhe se për parregullsi të caktuara zgjedhore nuk është siguruar mbrojtje e plotë ndëshkuese juridike, gjegjësisht se nevojiten përmirësime dhe saktësime të caktuara në veprimet e kryerjes së veprave të caktuar penale përmes parashikimit të

²³ Ky është inkriminim i ri i vendosur me ndryshimet e vitit 2006;

²⁴ Gazeta zyrtare e RM nr.73/06

formave të kualifikuara, por edhe privilegjim i disa veprimeve të kryerjes në drejtim të relaksimit të politikës ndëshkuese në lidhje me ato. Në lidhje me problemet e identifikuar nëpërmjet metodës juridiko komparative, në raportin final do të jepen shqyrtime komparative dhe disa propozime dhe sugjerime. Në tekstin e mëtutjeshëm do të jepet qasja ndaj disa aspekteve të mbrojtjes juridiko-penale në praktikë pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të vitit 2008.

1. Persona të kallëzuar

Pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2006, deri te prokuroritë publike u parashtruan kallëzime për gjithsej 28 persona²⁵, ndërsa pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të mbajtura në vitin 2008 nga ana e MPB u parashtruan 211 kallëzime penale kundër 213 personave²⁶ si dhe 11 kallëzime penale kundër 142 personave nga ana e partisë politike BDI²⁷.

Kjo rritje e dukshme e kryesve të kallëzuar të veprave penale në lidhje me zgjedhjet parlamentare të vitit 2006, mund të interpretohet se është rezultat i prishjes së dukshme të disa segmenteve nga procesi zgjedhor me numër të rritur të frikësimeve dhe dhunës që është regjistruar edhe nga ana e vëzhguesve të zgjedhjeve, por nga ana tjetër mund të interpretohet edhe si rritje e efikasitetit në zbulimin dhe ndjekjen e kryesve të veprave penale nga ana e organeve kompetente.

2. Struktura e veprave të kallëzuara

Nga të dhënat të cilat Koalicioni i grumbulloi prej shkresave të prokurorive publike vërehet se numri më i madh i lëndëve janë formuar në lidhje me veprën penale Pengim i zgjedhjeve dhe votimit, derisa numër dukshëm më i vogël ka të bëjë me veprat penale Keqpërdorim i të drejtës votuese, Thyerje e të drejtës votuese dhe në lidhje me Shkatërrimin e dokumenteve zgjedhor. Gjatë kësaj, pjesa më e madhe e lëndëve të formuara për veprën Pengimi i zgjedhjeve deh votimit ka të bëjë me nenin 158 paragrafi 2, që do të thotë se të dyshuarit ngarkohen para së gjithash për vepra të kryera me përdorim të armëve ose mjeteve eksplozive, me

²⁵ Vitllarov, Analizë e mbrojtjes penale juridike të zgjedhjeve dhe votimit, 2008

²⁶ E dhëna është marrë nga Misioni vëzhgues i OSBE në Shkup

²⁷ Shkresë e PPTH Tetovë 24 nëntor 2008

përdorim të dhunës kundrejt më tepër personave, si dhe në raste kur vepra është kryer nga ana e grupit të organizuar ose në më tepër vendvotime. Mënyra e dhunshme e kryerjes së kësaj vepre vërtetohet edhe me të dhënën se në numrin më të madh të rasteve, të dyshuarit për veprën Pengim i zgjedhjeve dhe votimit njëkohësisht ndiqen edhe për veprën Përpunim, mbajtje dhe tregti me armë ose materiale shpërthyes.

Gjatë krahasimit të strukturës së veprave të kallëzuara me strukturën e parregullive të vërtetuara nga ana e vëzhguesve (shiko kontekstin) vërehet se edhe pse si parregullsi më të shpeshta paraqiten votimi familjar, votimi në vend të tjetrit dhe mbushja e kutive votuese, që në një mënyrë sugjeron se në strukturën e veprave penale të kallëzuara do të dominojnë veprime të cilat do të përmbliidhen nën veprat penale Keqpërdorim i të drejtës votuese, Thyerje e fshehtësisë së votimit ose Thyerje e lirisë së përcaktimit të votuesve, mirëpo situatë e atillë nuk paraqitet në strukturën e veprave penale të kallëzuara.

3. Vendi i kryerjes së veprave të kallëzuara

Nga aspekti i vendit të kryerjes së veprave të kallëzuara, vërehet se më së shumti vepra penale janë kallëzuar në PPTH Gostivar (duke përfshirë Dibrenë) ku janë formuar 23 lëndë kundër 111 personave²⁸, pastaj vijojnë PPTH Tetovë ku janë formuar 20 KO lëndë kundër 83 personave dhe 2 kryesve të panjohur²⁹, PPTH Shkup ka formuar 5 KO lëndë kundër 19 personave, PPTH Strugë 2 KO lëndë kundër 3 personave dhe PPTH Strumicë 1 KO lëndë kundër 1 personi. Sa i përket çështjes se a janë veprat e kryera në vendvotim, prej shkresave të prokurorive publike në të cilat janë theksuar edhe përshkrime të shkurta të ngjarjeve juridiko-penale, vërehet se paraqitet numër më i madh i veprave që janë kryer jashtë vendeve të votimit.

Këto të dhëna tregojnë se pjesa më e madhe janë kryer në pjesën veri-perëndimore të vendit, dhe ajo që është interesante se paraqitet numër i caktuar i veprave penale kundër zgjedhjeve dhe votimit që janë kryer jashtë vendeve të votimit.

²⁸ Shkresë e Prokurorisë publike themelore Gostivar deri te Koalicioni Të gjithë për gjykime të drejta, 28 tetor 2008;

²⁹ Shkresë e Prokurorisë publike themelore Tetovë deri te Koalicioni Të gjithë për gjykime të drejta, 24 nëntor 2008;

4. Organizueshmëria gjatë kryerjes së veprave të kallëzuara

Deri më 74% të lëndëve të formuara në PPTH Gostivar³⁰ dhe 65% të lëndëve të formuara nga ana e PPTH Tetovë³¹ në lidhje me veprat kundër zgjedhjeve dhe votimit, vërehet pjesëmarrje e 3 ose më tepër persona në kryerjen e veprës. Kjo e dhënë vërtetohet me informatën se pjesa më e madhe e personave të kallëzuar ndiqen për veprën Pengim i zgjedhjeve dhe votimit nga neni 158 paragrafi 2, për shkak se vepra është kryer nga ana e grupit të organizuar ose në më tepër vendvotime që çon të mendohet se ndërmjet kryesve të veprave penale kundër zgjedhjeve dhe votimit ka ekzistuar shkallë e caktuar e organizimit dhe koordinimit me qëllim të kryerjes të këtij lloji të veprave penale. Ky përfundim mbështetet edhe me rastin K. Nr. 45/08 në të cilin shtatë vetë u dënuan për veprën Bashkim kriminel nga neni 394 i KP dhe në të cilin gjyqi vërtetoi se qëllimi për krijimin e grupit është kryerje e veprave penale kundër zgjedhjeve dhe votimit.

5. Veprimi i prokurorive publike

Nga aspekti i veprimit të Prokurorisë publike Tetovë ndaj veprave të paraqitura, nga të dhënat të cilat i morri Koalicioni Të gjithë për gjykime të drejta me shkresën e 24 nëntorit 2008, mund të përcaktohet se janë formuar 20 lëndë sipas kallëzimeve të parashtruara nga ana e MPB Tetovë. Sa i përket lëndëve të formuara me ditën e shkresës së PPTH Tetovë për 10 lëndë janë parashtruar kërkesa për kryerje të hetimit për 53 persona. Në 3 lëndë në të cilat janë përfshirë 10 persona dhe 2 kryes të panjohur, pas hetimit të kryer është kërkuar plotësim i hetimit. Për 6 lëndë me të cilat janë përfshirë 12 persona është parashtruar aktakuzë pas hetimit të kryer. Në një lëndë me të cilën janë përfshirë 8 persona, pas hetimit të mbaruar lënda është kthyer te prokurori publik për vendosje. Nga shkresa vërehet edhe se 11 kallëzime penale kundër 142 personave janë parashtruar nga ana e partisë politike BDI. Sa i përket këtyre kallëzimeve nga ana e PPTH Tetovë janë kërkuar informata të nevojshme nga MPB Tetovë.

³⁰ Shkresë e Prokurorisë publike themelore Gostivar deri te Koalicioni Të gjithë për gjykime të drejta, 28 tetor 2008;

³¹ Shkresë e Prokurorisë publike themelore Tetovë deri te Koalicioni Të gjithë për gjykime të drejta, 24 nëntor 2008;

Sa i përket veprimeve të Prokurorisë publike Gostivar sipas veprave të kallëzuara, nga të dhënat të cilat Koalicioni Të gjithë për gjykime të drejta i pranoi me shkresën e datës 28 tetor të vitit 2008 mund të kuptohet se janë formuar 23 lëndë sipas kallëzimeve nga ana e MPB Gostivar. Në lidhje me lëndët e formuara përfundimisht me ditën e shkresës, 9 lëndë në të cilat janë përfshirë 55 persona, gjenden në fazë të hetimit, ndërsa 14 lëndë me të cilat janë përfshirë 56 persona gjenden në fazë të grumbullimit të informatave të nevojshme.

Në PPTH Shkup janë formuar 5 lëndë kundër 19 personave prej të cilëve për 8 persona është refuzuar kalëzimi penal ose është ndërprerë hetimi.

Në PPTH Strugë janë formuar 2 lëndë kundër 3 personave, ndërsa PPTH Strumicë ka formuar 1 lëndë kundër 1 personi për të cilin është ndërprerë hetimi. Të gjithë këto të dhëna rreth veprimit të Prokurorisë publike janë tabeluar duke i dhënë burimet e të dhënave në një tabelë në formë të shtesës në fundin e këtij raporti.

Si një prej problemeve kryesor i cili ndikon mbi efikasitetin e ndjekjes së kryesve të veprave penale kundër zgjedhjeve dhe votimit, nga ana e prokurorëve publik, nënvizohet problemi me pamundësinë për sigurimin e fakteve me relevantë juridike³². Për shkak të mungesës së fakteve. Janë dhënë numër i madh i deklaratave për heqje dorë nga ndjekja e veprave të kallëzuara. Problemi rrjedh prej ekzistimit të frikës të votuesit dhe administrata zgjedhore që të dëshmojnë për ngjarjet për shkak të kërcënimeve nga ana e aktivistëve partiak. Ashtu, theksohet dukuria e ndryshimit të deklaratës së dhënë në bisedat informative dhe para gjykatësit hetues, si dhe dukuria e mënjanimit të realizimit të këtij obligimi qytetar³³. Nga ana tjetër, vërehet jokooordinim i organeve të ndjekjes me KSHZ në procesin e sigurimit të fakteve relevante juridike, ashtu që vetëm në disa raste nga ana e prokurorisë publike janë kërkuar informime nga KSHZ në lidhje me ngjarje të caktuara penale juridike, edhe pse numër i madh i fakteve për vepra penale të kryera janë përcaktuar nga ana e KSHZ në procedurat për mbrojtje të të drejtave zgjedhore.

³² Ibid

³³ Ibid

6. Kohëzgjatja e procedurës

Nga të dhënat e lëndëve të monitoruara deri tani në lidhje me kohën e kaluar nga momenti i pranimit të aktakuzës në gjyq, e deri në caktimin e seancës së parë, rrjedh se vetëm në 50% të rasteve afati i udhëzuar prej 30 ditëve është respektuar, megjithatë duhet theksuar se vonesat nuk paraqesin intervale kohore të gjata.

Nga aspekti i kohëzgjatjes së procedurave veçse të mbaruara në shkallën e parë, nga stadiumi i aktakuzës deri në shqiptimin e verdiktit, në 1 rast procedura ka zgjatur prej 15 deri më 30 ditë, në 1 rast ka zgjatur deri në 45 ditë, dhe në dy raste ka zgjatë 100 ditë, që tregon në faktin se në lidhje me këto procedura të monitoruara personat e paditur për vepra penale kundër zgjedhjeve dhe votimit të kryera gjatë zgjedhjeve parlamentare të vitit 2008, janë gjykuar në afat të arsyeshëm dhe me shkallë mjaft të lartë të urgjencës në veprimin.

Nga aspekti i shtyrjeve të dëgjimit kryesor në 6 raste të monitoruara, intervali është prej 31 deri 60 ditëve dhe në 1 rast shtyrja zgjat më tepër se 60 ditë që ka rezultuar në rifillim të dëgjimit kryesor. Si shkak për shtyrje vetëm në 20% të rasteve paraqitet mungesa e një ose më tepër aktorëve relevant, derisa në 80% të rasteve sesioni është shtyrë për shkak të sigurimit të fakteve të reja ose për shkak të përgatitjes së mbrojtjes. Gjatë kësaj, si e dhënë interesante paraqitet ajo se nuk ekziston rast i shtyrjes së dëgjimit kryesor për shkak të mossigurimit të prezencës së të paditurit, që deri diku çon drejt përfundimit se racionalist përdoren masat për sigurim të prezencës së të pandehurve. Vërehet edhe se të lëndët në të cilat është shqiptuar masa paraburgim ndaj personit(ave) të pandehur, një përsheptim në veprimin që është edhe logjike për shkak se sipas lëndëve me paraburgim veprohet në pajtim me parimin e urgjencës.

Prej të dhënave të grumbulluara deri tani, si shkak më i shpeshtë për shtyrje të dëgjimit kryesor paraqitet nevoja për sigurimin e fakteve në 50% të rasteve, që vetëm e vërteton tezën se sigurimi i fakteve relevant juridik është problemi kryesor në procedimin e këtyre veprave. Në këtë rast ato paraqiten si arsye kryesore për (mos)sigurimin e zhvillimit në kontinuitet të dëgjimit kryesor.

Pjesa e tretë: Përfundime

Në bazë të vështrimeve të paraqitura sipër për gjendjen momentale me veprimet në lidhje me përgjigjet institucionale kundër parregullsive zgjedhore, arrihet deri në përfundimet vijuese:

Përfundime:

1. Evidente është nevoja e **përforcimit të kapacitetit të Komisionit shtetëror zgjedhor në të gjitha fazat e procesit zgjedhor**. Veçanërisht duhet të punohet në avancimin e kapacitetit personal, profesional, teknik dhe edukativ të Komisionit shtetëror zgjedhor, si dhe nevoja për koordinim dhe lidhshmëri më të madhe mes KShZ dhe organeve tjera shtetërore të cilët sigurojnë mbështetje logjistike në procesin zgjedhor (Ministria e drejtësisë, Ministria e punëve të brendshme, Agjencia për nëpunës shtetëror).

2. Fakti se **KShZ se gjatë zgjedhjeve të parakohshme parlamentare nuk arriti të sigurojë mbrojtje maksimale** për pjesëmarrësit e procesit zgjedhor kur të drejtat e tyre ishin të rrezikuara gjatë fushatës zgjedhore, në mënyrë të drejtpërdrejtë implikon nevojë që Komisioni shtetëror zgjedhor të tregojë **vendosmëri dhe përkushtim në zbatimin e dispozitave ligjore**. KShZ do të duhej të tregojë interesim më të madh për krijimin aktiv të zgjidhjeve (udhëzime, mendime, etj.) për përmirësim kualitativ të procesit zgjedhor në Republikën e Maqedonisë.

3. Komisioni shtetëror zgjedhor duhet të demonstrojë gatishmëri që në mënyrë të shpejtë dhe me vendosmëri të ballafaqohet me të gjithë problemet të cilat paraqiten si rezultat i punës së organeve më të ulëta zgjedhore. Gatishmëri të njëjtë KShZ duhet të tregojë edhe kur ballafaqohet me parregullsitë që i shkaktojnë pjesëmarrësit në procesin zgjedhor. Komisioni shtetëror zgjedhor nuk guxon të mbetet pasiv dhe të mos ngrejë procedura kundërvajtëse në raste të thyerjes evidente të dispozitave ligjore nga ana e pjesëmarrësve në zgjedhje veçanërisht në pjesën e fushatës zgjedhore. Edhe një herë përsëritet nevoja për parashikimin e kompetencës ligjore që **KShZ të udhëheqë procedura kundërvajtëse dhe të shqiptojë sanksione kundërvajtëse. Patjetër duhet që KShZ edhe ligjërisht të caktohet si organ kundërvajtës.**

4. Për shkak të thyerjeve të konstatuara të dispozitave ligjore në pjesën e financimit të fushatës zgjedhore, edhe një herë imponohet nevoja për ndryshim të rregullores ligjore në pjesën e kohës kur raportet e revizionit duhet të dorëzohen deri te KShZ dhe vërtetimi i pasojave direkte për pjesëmarrësin e zgjedhjeve nëse Enti shtetëror për revizion ka evidentuar shpenzim të paligjshëm të mjeteve gjatë fushatës.

5. Në lidhje me mënyrën e kryerjes së veprave penale ekziston rritje e zbatimit të aplikimit të elementeve të dhunës gjatë kryerjes së veprave penale kundër zgjedhjeve.

6. Mungon përgjigje institucionale efikase në lidhje me veprimet me të cilat thyhet liria e përcaktimit, patjetërsimi e të drejtës votuese dhe fshehtësia e votimit.

7. Politika e ashpërsuar ndëshkuese në lidhje me veprat penale kundër zgjedhjeve dhe votimit e cila u bë në vitin 2006, nuk dha rezultat pozitiv në fushën e parandalimit të përgjithshëm.

8. Ekziston zvogëlim i madh i lëndëve nga njëra fazë në tjetrën gjatë ndjekjes penale.

Shtesë: Tabela e veprave penale

Vendi	Persona të kallëzuar nga MPB ¹	Numri i personave për të cilët është:				Ngritur aktakuzë	Verdikte në shkallë të parë	Persona të liruar nga akuza	Numër i personave të shpallur fajtor
		Formuar lëndë në PP ²	Refuzuar kallëzimi penal ose është ndërprerë hetimi	Grumbullohen të dhënat e nevojshme, kërkohen ose veçse zhvillohet hetimi					
PPTH Shkup	37	19	8	1	10	3	0	13 ³	
PPTH Tetovë ⁴	69	83	-	80	3	1	0	1 ⁵	
PPTH Gostivar ⁶	102	111	3	108	1	1	1	0	
PPTH Strugë ⁷	1	3	-	2	1	1	-	1 ⁸	
PPTH Strumicë ⁹	2	1	1	0	0	-	-	-	

¹ E dhëna është marrë nga Misioni vëzhgues i OSBE në Shkup

² PP e RM, 02 shtator 2008

³ 1 person me dënim me burg prej 6.5 vjetëve; 6 persona me nga 6 vjet burg; 2 persona nga 5vjet 3muaj; 2 persona nga 1.5vjet; 1 person – 1vjet 7muaj; 1person – 3.5 vjet dënim me burg

⁴ PPTH Tetovë, 24 nëntor 2008

⁵ 1 person me dënim 1 vjet burg

⁶ PPTH Gostivar, 31 tetor 2008

⁷ PP e RM, 02 shtator 2008

⁸ 1 person me dënim 1 vjet burg

⁹ PP e RM, 02 shtator 2008